

Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë

Objekti: Aksesi në informacion në lidhje me të dhënat për avokatët e caktuar nga shteti në procedimet penale

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin\)](#)

Aplikanti: Komiteti i Helsinkit, Hungari

Gjykata vendosi: Shkelje të Nenit 10

Aplikanti është Komiteti i Helsinkit, një OJF në shtetin Hungarez, që po monitoronte mënyrën e caktimit të avokatëve kryesisht në procesin penal. Nga rezultatet paraprake të monitorimit u konstatua që komisaritet e policisë nuk caktonin avokatin kryesisht nga lista e vendosur në dipozicion nga Dhomat e Avokatisë, por në mënyrë të përsëritur avokatët që caktoheshin për të mbrojtur të pandehurin zgjidheshin nga skema e ofrimit të ndihmës ligjore falas. Me synimin për të mbledhur informacion zyrtar për këtë çështje, OJF-ja i drejtohet me një kërkesë për informacion 24 komisariateve policore, duke i kërkuar informacion për emrat e avokatëve të caktuar kryesisht, si dhe numrin se sa prej tyre ishin caktuar për të përfaqësuar të pandehurit e varfër, në bazë të skemës së ndihmës juridike. Edhe pse 22 komisariate i vendosën në dispozicion informacionin e kërkuar (në disa raste pas ankesave të suksesshme ligjore), 2 prej tyre nuk e dhanë informacionin me arsyetimin e mbrojtjes të të dhënave personale. Aplikanti kundërshtoi përgjigjiet refuzuese të komisariateve të policisë, duke e çuar çështjen deri në Gjykatën e Lartë, e cila nuk e pranoi kërkesën e aplikantit,

duke u shprehur se: “Emrat dhe numrat e caktimit të avokatit mbrojtës përbëjnë të dhëna personale [...] Departamentet përgjegjëse të policisë nuk mund të detyrohen të japin këto të dhëna personale.” Është interesant fakti, që edhe pse Gjykata e Lartë ka pranuar se avokatët e caktuar kryesisht kryejnë efektivisht një detyrë publike, ato nuk mund të konsiderohen si funksionarë publike, pasi puna e tyre (p.sh. garantimi i ndihmës juridike për të pandehurit e varfër), është private dhe për këtë arsye emrat e tyre apo numri i rasteve që përfaqësojnë / statistikën në lidhje me emërimet e tyre, nuk përbëjnë informacion zyrtar. Si rezultat i kësaj, kërkuesi nuk kishte të drejtë për ta marrë këtë informacion. Aplikanti parashtroi një kërkesë përpara GJEDNJ.

Duhet theksuar se ky nuk është aplikimi i parë që paraqitet para GJEDNJ për akses në të drejtën e informimit, ose më saktë aplikimi i parë kundër Hungarisë – dy vendime të rëndësishme në lidhje me të drejtën e informimit janë marrë kundër Hungarisë. OJF-ja aplikante duhet të ketë qenë shumë e befashuar kur është informuar se Dhoma që po gjykonte çështjen, vendosi të kalojë çështjen në juridiksionin e Dhomës së Madhe. Kjo procedurë ndodh vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe zakonisht kur GJEDNJ-ja vendos që të ndryshojë jurisprudencën e saj, ose të vendosë një kurs të ri jurisprudencial.

Është interesant fakti, që qeveria e Mbretërisë së Bashkuar vendosi të ndërhyjë në procedurat para Dhomës së Madhe, duke paraqitur një ndërhyrje si palë e tretë. Në parashtimet e paraqitura, Qeveria mbajti anën e palës së paditur, shtetit Hungarez, duke kontestuar fuqimisht pretendimet e palës kërkuese, që neni 10 i Konventës parashikon dhe të drejtën e aksesit në informacionin e dokumentave zyrtarë. Të dy qeveritë, ajo Hungareze dhe Mbretëria e Bashkuar, cituan një seri vendimesh të GJEDNJ, të marra në vitin 1980, në të cilat Gjykata (në atë kohë) hodhi poshtë argumentin se neni 10 garantonte të drejtën e informimit dhe GJEDNJ nuk mund të angazhohet në atë që konsiderohet “ligjvënës gjyqësor”,

përkatësisht duke lexuar një të drejtë në Konventë që nuk është parashikuar nga hartuesit e saj.

Pas një analize shumë të gjatë, GJEDNJ-ja në fund u shpreh se e drejta për të kërkuar informacion garantohet sipas nenit 10, megjithatë sipas disa kushteve: Së pari, paditësi duhet të kërkojë dhënien e informacioneve në mënyrë që të kontribuojë në një debat publik. Së dyti, informacioni i kërkuar duhet të jetë i një natyre të interesit publik. Së treti, identiteti i personit që kërkon informacion ai / ajo kryen një funksion “social watchdog – rojtar social” (p.sh. nëse ai /ajo është një gazetar, OJF, apo një studiues akademik) duhet gjithashtu të merret parasysh, dhe së katërti, informacioni kërkuar duhet të ekzistojë dhe të mbahet nga autoritetet publike. Duke i aplikuar këto kushte në çështjen konkrete, GJEDNJ-ja vuri në dukje se OJF –ja aplikuese ka kërkuar informacion që ishte i nevojshme për përfundimin e anketës në lidhje me funksionimin e skemës së avokatëve të caktuar kryesisht, një çështje e cila kishte “dukshëm” një interes publik (efektiviteti i skemës). Për më tepër, ankuesi ishte një OJF që kryen veprimtari monitoruese, ndërsa informacioni i kërkuar ishte “i gatshëm dhe në dispozicion” të autoriteteve. Të katër kriteret janë përmbushur, pra, refuzimi i autoriteteve për t’i dhënë aplikantit informacionin e kërkuar ishte në shkelje të nenit 10.

Çfarë ndodh në qoftë se një qytetar i thjeshtë (por shumë kurioz) kërkon informacion, që në të vërtetë nuk mund të kontribuojë në debatin publik? Megjithëse kjo pyetje është e zgjidhur nga legjislacioni shqiptar dhe qytetarët në Shqipëri nuk kanë asnjë arsye pse të shqetësohen dhe se kjo pyetje vlen për vendet që nuk kanë një ligj të posaçëm për të drejtën e informimit, një interpretim i ngushtë për zbatimin e katër kushteve të përmendura më sipër, parashikon që autoriteti publik ka të drejtë (sipas Nenit 10) të refuzojë të drejtën e aksesit në informacion. Prandaj do të jetë interesante për të parë se si GJEDNJ do të interpretojë dhe zbatojë këto kritere

në të ardhmen. Mjaft interesante, në vendimin e saj GJEDNJ-ja tashmë tërthorazi ka pranuar, se do të miratojë një qasje më liberale për aplikimin e këtyre kriterëve në të ardhmen; kështu Gjykata u shpreh se blogerët dhe përdoruesit e mediave sociale mund të konsiderohen si “rojtare sociale” për qëllimet e testit.

Guseva kundër Bullgarisë, nr. 6987/07, 17 Shkurt 2015

Objekti: Aksesi në informacionet mjedisore (mbledhja e qenve të rrugës) / dhënia e një tenderi nga një bashki

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin\)](#)

Aplikanti: Një anëtar dhe përfaqësues i një OJF-ve active në mbrojtjen e të drejtave të kafshëve

Gjykata vendosi: Shkelje e Neneve 10 dhe 13

Aplikanti fitoi tre gjyqe në gjykatat vendase, kundër një kryetari bashkie, për të siguruar informacion në lidhje me trajtimin e kafshëve endacake që gjenden në rrugët e qytetit. Kryetari i bashkisë nuk i ishte përmbajtur vendimeve. Gjykata vuri në dukje se sipas ligjit të brendshëm në fuqi në atë kohë, nuk ka pasur afatet kohore të caktuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i informacioneve ishte në diskrecionin e bashkisë. Duke pranuar se një vonesë e caktuar në zbatimin e një vendimi mund të jetë legjitime, Gjykata

gjithashtu vuri në dukje se informacioni, njëlloj si lajmet, është një mall që kalbet dhe duhet të shpaloset me shpejtësi. Gjykata u shpreh gjithashtu se mjetet juridike në dispozicion të ankuesit (të tilla si padia për shpërblimin e dëmit për shkak të mosdhënies së informacionit, gjobat ndaj zyrtarëve shtetërorë që refuzojnë të zbatojnë një vendim të formës së prerë), nuk janë në parim mjete juridike adekuate; Ajo që aplikanti kërkon është marrja e informacionit dhe jo dënimi i zyrtarëve që nuk e lëvrojnë atë.

Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung eines wirtschaftlich gesunden Land – und forstwirtschaftlichen Grundbesitzes kundër Austrië, nr. 39534/07, 28 Nëntor 2013

Objekti: Aksesi në informacion për transferimin e pronësisë mbi tokën bujqësore / pyjore

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin\)](#)

Aplikanti:

OJF për kërkime shkecore

Gjykata vendosi:

Shkelje e Nenit 10

Aplikanti ishte një OJF që kryente kërkime mbi ndikimin e transferimit të pronësisë së tokës bujqësore dhe pyjore. Në vazhden e veprimtarive të saj, ajo ka kërkuar nga Komisioni Rajonal për Transaksionet e Pronës së Patundshme që të pajises me kopjet e të gjitha vendimeve që ishin lëshuar gjatë një viti të caktuar. Ajo pranoi se të dhënat personale të palëve dhe informacione të tjera të ndjeshme mund të redaktohen dhe u shpreh e gatshme të mbulonte çdo kosto. Komisioni refuzoi duke u justifikuar me mungesën e kohës dhe personelit, një vendim që u la në fuqi edhe nga gjykatat vendase. Edhe pse Gjykata nuk e pranoi argumentin e ankuesit se autoriteti kishte një detyrim të përgjithshëm sipas nenit 10 për të publikuar të gjitha vendimet në një bazë të dhënash elektronike ose për të siguruar një kopje të anonimizuar, pranoi se duke lënë jashtë të dhënat personale dhe duke e bërë kopjet e një numri të konsiderueshëm të vendimeve kërkon kohë dhe konsumon burime, ajo gjithashtu vuri në dukje se ankuesi kishte rënë dakord që të dhënat personale të redaktohen dhe kishte ofruar pagimin e kostove të riprodhimit dhe dërgimit me postë. Përveç kësaj, Gjykata shprehu habinë se asnjë nga vendimet e Komisionit nuk ishte botuar, në mënyrë elektronike ose ndryshe, ndërkohë që të gjithë Komisionet e tjerë rajonale rregullisht i publikonin të tilla vendime dhe e kishin pajisur aplikantin me kopje të anonimizuara. Si pasojë, vështirësitë e referuara nga Komisioni vinin për shkak të zgjedhjeve që kishte bërë vetë Komisioni që të mos publikojë asnjë nga vendimet e tij dhe si rrjedhojë, nuk mund të përdorte si argument këto vështirë për të refuzuar kërkesën e ankuesit.

Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë, nr. 48135/06, 25 Qershor 2013

Objekti: Aksesi nga OJF-të në informacione të agjencie inteligjente

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin\)](#)

Aplikanti: OJF për të drejtat e njeriut

Gjykata vendosi: Shkelje e Nenit 10

Çështja kishte të bënte me refuzimin nga Agjencia e Inteligjencës Serbe për të siguruar aksesin e aplikantit, një OJF për të drejtat e njeriut, në të dhënat statistikore lidhur me numrin e individëve i nënshtrohen mbikqyrjes elektronike. Agjencia kishte dhënë informacione kontradiktore, duke argumentuar që të dhënat nuk mund të zbulohen për shkak të sigurisë kombëtare dhe pastaj se nuk kishte të dhëna të tilla në dispozicion. Gjykata vuri në dukje se informacioni statistikor duhet në parim të jetë gjithmonë në dispozicion pasi ky lloj informacioni është shumë i lehtë për t'u mbledhur. Gjykata gjithashtu nuk pranoi të pajtohet me mosekzekutimin e vendimin të Komisionerit për Informim që urdhëronte qeverinë të publikonte informacionin, një refuzim që Gjykata e konsideroi arbitrar. Gjykata më tej u shpreh se Qeveria e Serbisë duhej të japë informacion shpjegues në bazë të nenit 46 të Konventës, duke mos u shprehur vetëm që ka shkelje në Nenit 10, por duke urdhëruar edhe veprime konkrete për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur.

Kenedi kundër Hungarisë, nr. 31475/05, 26 Maj 2009

Objekti: Aksesi në dokumente të klasifikuara të Shërbimit Sekret Hungarez të viteve 1960

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin\)](#)

Aplikanti: Historian

Gjykata vendosi: Shkelje e neneve 6 dhe 10

Gjykata konstatoi se refuzimi i zbatimit të vendimeve të gjykatave vendase për aksesin në dokumente të caktuara lidhur me funksionimin e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit me qëllim përgatitjen e një studimi, përbënte jo vetëm një shkelje të së drejtës së tij sipas Neni 6 për mosekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë, por edhe shkelje të së drejtës për informim sipas Neni 10. Më konkretisht, Gjykata u shpreh se “aksesi në dokumentet origjinale për hulumtime legjitime historike ishte një element thelbësor i ushtrimit të së drejtës së ankuesit për lirinë e shprehjes” dhe konsiderohet se refuzimi i autoriteteve për të zbuluar informacionin ishte arbitrar.

Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë, nr. 37374/05 14 Prill 2009

Objekti: Aksesi në ankesën në Gjykatën Kushtetuese për kushtetushmërinë e disa amendamenteve në Kodin Penal që lidheshin me krime që kishin të bënin me trafikun e drogës, e dorëzuar nga një deputet

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin në anglisht\)](#)

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin në shqip\)](#)

Aplikanti: OJF për të drejtat e njeriut

Gjykata vendosi: Shkelje e Nenit 10

Duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së aplikantit që përfshinte çështje gjyqësore për të drejtat e njeriut në fushën e mbrojtjes së lirisë së informacionit, gjykata e karakterizoi OJF-në ankuese si një “roje” sociale, aktiviteteve të së cilës i duhej garantuar mbrojtje e ngjashme nga Konventa me atë që i jepet shtypit. Gjykata më tej vërejti se një kërkesë për rishikimin abstrakt të kushtetutshmërisë, veçanërisht kur bëhet nga një deputet, pa dyshim përbën një çështje të interesit publik. Gjykata ishte kritike ndaj vendimit të gjykatave vendase që refuzuan aksesin në dokument me argumentin se përmbante të dhëna personale, pasi veprimet e në fjalë (dorëzimi i ankesës), nuk kishin të bënin me jetën private të deputetit dhe, në çdo rast, çdo e dhënë personale mund të redaktohej; në të kundërtën, statusi i tij si një figurë publike do të thotë se ai duhet të presë një shkallë më

të lartë shqyrtimi nga shtypi dhe OJF-të. Gjykata më tej vuri në dukje se informacioni i kërkuar ishte në dispozicion të autoriteteve dhe nuk ishin të nevojshme që prej tyre të mblidhej ndonjë e dhënë shtesë. Së fundi, Gjykata konsideroi se monopoli i informacionit çon në censurë dhe vuri në dukje se pengesa të projektuara për të penguar aksesin në informacione në interesin publik mund të dekurajojë ata që punojnë në media ose në sektorin e OJF-ve në kryerjen e rolit të tyre të rëndësishëm të “rojës publike”.

Sdružení Jihočeské Matky kundër Republikës Çeke, nr. 19101/03, 17 Qershor 2003

Çështja: Sdružení
Jihočeské Matky kundër Republikës Çeke, nr. 19101/03, 17
Qershor 2003

[\(Kliko këtu për të shkarkuar vendimin në
frengjisht\)](#)

Objekti: Akses i në
dokumentat lidhur me një central bërthamor

Aplikanti: OJF ambientaliste

Gjykata vendosi: Nuk ka shkelje të Nenit 10

Gjykata Evropiane mori parasysh, për herë të parë në

jurisprudencën e saj, se refuzimi për të lejuar aksesin në dokumente publike duhej të konsiderohej si një ndërhyrje në të drejtën e kërkuarit për akses në informacione të mbrojtura në bazë të nenit 10 të Konventës. Edhe pse në fund të fundit Gjykata e refuzoi kërkesën, atë e bëri pasi vuri në dukje për herë të parë, se një seri dokumentesh (të tilla si Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në lidhje me funksionimin e centralit), janë bërë publike dhe e dyta, se dokumentet e papublikuara (detajet në lidhje me funksionimin e centralit) përbënin ose një tregtar ose një sekret shtetëror dhe nuk kishte interes publik që të legjitimonte publikimin e tyre – ndryshe nga publikimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.